



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 342, Datë 21.12.2022

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË 31.05.2019, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “THIRRË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1820 KW, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/1 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1820 kW”, i ndryshuar”,

Konstatohet se:

- ERE me vendimin nr. 83, datë 31.05.2019, të ndryshuar, ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “THIRRË”, me kapacitet të instaluar 1820 kW, për një afat 30 vjeçar.
 2. Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. të depozitojë në ERE, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97 Prot, datë 08.05.2017, përpara datës 27.04.2022.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje dhe më tej ka vijuar korrespondencat drejtuar shoqërisë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 845/1 datë 31.05.2022 shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka bërë me dije se ka aplikuar dhe është në pritje të rinovimit të lejes të përdorimit të burimit ujor nga Agjencia e Mbrotjtjes së Burimeve Ujore (AMBU).

- ERE në vijim të takimit të datës 02.06.2022 me përfaqësues të AMBU-së ka shkëmbyer korrespondenca të vazhdueshme me këtë institucion, ku së fundi edhe me shkresën nr. 1833 prot., datë 18.10.2022, në lidhje me konstatimin nga AMBU të disa HEC-eve që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike pa patur leje të përdorimit të burimit ujqor, duke i kërkuar ndër të tjera informacion në lidhje me mënyrën sesi do të konsiderohen subjektet që kanë aplikuar për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujqor përkatës dhe gjatë këtij procesi i përfundon afati i vlefshmërisë së lejes me të cilën është pajisur, siç rasti i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k, së cilës i ka përfunduar leja në datën 27.04.2022 dhe ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar fillimisht në datën 16.03.2022 dhe më pas ka riaplikuar përsëri në datën 26.04.2022.
- Në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1833/1, datë 21.10.2022, AMBU ndër të tjera ka kthyer përgjigje edhe për shoqërinë “SANG 1” sh.p.k, duke cilësuar se kjo shoqëri ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor për HEC “Thirrë” dhe aplikimi është në fazën e kryerjes së pagesës së tarifës për marrjen e lejes nga subjekti përfitues.
- Në vijim me shkresën nr. 2055/1 prot. datë 14.12.2022 shoqëria “SANG 1” sh.p.k ka depozituar vendimin nr. 23, datë 12.10.2022, *Për miratimin e saktësimin të koordinatave dhe rinovimin e lejes, HEC “THIRRË” dhe Lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 433 , datë 24.10.2022 me afat vlefshmërie 5 vjet.*
- Me depozitimin e dokumentacionit si më sipër nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit nr. 83/2019 i ndryshuar, të ndryshojë dhe bëhet:
 2. *Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujqor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).*
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 83/2019, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
 2. *Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., të përcjellë në ERE jo më vonë se data 13.10.2027, lejen e përdorimit të burimit ujqor me afat të rinovuar (data e përfundimit të lejes 12.10.2027).*

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI